



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 08.10.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 30.09.2020, të parashtruar nga Grupi Operatorve Ekonomik "Company Zuka Commerce" & "Marash Shped" sh.p.k., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi-asfaltimi i rrugëve në Komunën e Gjakovës"- Loti III-të: Ndërtimi –asfaltimi i rrugëve në fsh.Zhdrell-Bec, me Nr. të Prok: 632-20-4174-5-1-1, nxjerr:

V E N D I M

1. **1. Refuzohet** si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Grupit Operatorve Ekonomik "Company Zuka Commerce" & "Marash Shped" sh.p.k., e dt.30.09.2020, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi-asfaltimi i rrugëve në Komunën e Gjakovës"- Loti III-të: Ndërtimi –asfaltimi i rrugëve në fsh.Zhdrell-Bec, me Nr. të Prok: 632-20-4174-5-1-1, Nr. Brendshëm 632-20-063-511., kundër **NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES**, te AK –së, të datës 25.09.2020, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së .
2. Vërtetohet **NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES** e publikuar me datë: 25.09.2020;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që te vazhdoj me aktivitetin e prokurimit .
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

Arsyetim

Meqë Grupi Operatorve Ekonomik "Company Zuka Commerce" & "Marash Shped" sh.p.k., ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit Ndërtimi-asfaltimi i rrugëve në Komunën e Gjakovës"- Loti III-të: Ndërtimi –asfaltimi i rrugëve në fsh.Zhdrell-Bec, me Nr. të Prok: 632-20-4174-5-1-1, Nr. Brendshëm 632-20-063-511, Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 08.10.2020, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pas rishikimit të dokumenteve, autoriteti Kontraktues, konstaton se Operatori Ekonomik "REA" sh.p.k, i plotëson të gjitha kushtet e kërkuara në dosjen e tenderit dhe Autoriteti Kontraktues, mbetet pranë vendimit të marrë.

Tenderi juaj është i pasuksesshëm për arsye se ishte me çmim më të lartë.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;

Arkivët të Komunës

